



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Dt. 11.11.2024
Gjakovë

Komuna e Gjakovës, në bazë të nenit 68, paragrafi 3 i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 datë 04.06.2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, datë 04.06.2008), neni 19, 21, 22 dhe 28 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë me datën 30.04.2024, shpallë këtë:

KONSULTIM PUBLIK

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR QEVERISJE TË HAPUR

Konsultimi Publik për Planin Lokal të Veprimit për Qeverisje të hapur do të qëndrojë i hapur për 15 ditë, nga data **11.11.2024** deri me datën **25.11.2024**. Drafti i këtij dokumenti do të qëndroj online në ueb faqen zyrtare të komunës së Gjakovës në linkun: <https://kk.rks-gov.net/gjakove/kuvendi/draft-regulloret/>

Takimi Fizik, do të mbahet me datën **25.11.2024** me fillim prej orës **11:00** në sallën e kuvendit të komunës, objekti i ish – Bankos-it kati 4.

Ftohen qytetarët që të marrin pjesë në këtë takim dhe me idetë e propozimet konkrete të angazhohen në përmirësimin dhe zhvillimin e këtij dokumenti.

Me respekt,